

DORACAK

PËR PARASHTRIMIN E ANKESAVE INDIVIDUALE
PRANË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

UDHËZIME DHE HAPA TË THJESHTË



DORACAК

PËR PARASHTRIMIN E ANKESAVE INDIVIDUALE
PRANË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

UDHËZIME DHE HAPA TË THJESHTË

Botues:

Ministria e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Autorë:

Elena Georgievska dhe Aleksandra Cvetanovska –
Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj

Redaktor:

Tanja Kikerekova, udhëheqëse e Departamentit për
Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, Ministria e Drejtësisë së RMV

Lektor:

Vesna Kostovska

Dizajni:

ADD-VERTA LTD Doo Skopje

Ueb- faqet e publikimit: www.pravda.gov.mk dhe www.myla.org.mk



CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

341.649:[341.123.04:341.231.14.037(035)]

ГЕОРГИЕВСКА, Елена

Прирачник за поднесување индивидуална жалба пред Комитетот за човекови права : едноставни чекори и насоки / [автори Елена Георгиевска и Александра Цветановска]. - Скопје : Македонско здружение на млади правници, 2022

Начин на пристапување (URL): <https://www.myla.org.mk>. - Начин на пристапување (URL): <https://www.pravda.gov.mk>. - Текст во PDF формат, содржи 34 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 19.09.2022. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 31-34

ISBN 978-608-4843-65-8

1. Цветановска, Александра [автор]

а) Жалба -- Поднесување и постапка -- Комитет за човекови права при ОН -- Прирачници

COBISS.MK-ID 58177029



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Drejtësisë



МЗМП

PËRMBAJTJA:

Lista e shkurtesave	4
1. HYRJE	5
2. PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE	7
2.1. Informacion bazë mbi Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike	7
2.2. Të drejtat e parashikuara në Pakt	8
2.3. Protokolli Fakultativ i Paktit i cili rregullon procedurën e parashtrimit të ankesave individuale pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut në OKB	12
2.4. Komiteti për të Drejtat e Njeriut	13
3. MODEL, FORMULARI I ANKESËS INDIVIDUALE	14
3.1. Elementet që duhet t'i përmbajë ankesa	14
3.2. ADRESA E KOMUNIKIMIT	17
3.3. MODEL, FORMULARI I ANKESËS	17
4. PROCEDURA E VENDIMMARRJES SË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT, NË LIDHJE ME ANKESAT INDIVIDUALE	21
4.1. Kushtet e parashtrimit të ankesave individuale	21
4.2. PROCEDURA	21
5. RASTE	23
5.1. S.I.D. et al. v. Bulgaria No. 1926/2010	23
5.2. Marija and Dragana Novaković v. Serbia No. 1556/2007	28
Literatura e përdorur	32

LISTA

E SHKURTESAVE

- OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara
- MD - Ministria e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ShMJR - Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
- OHCHR - Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
- KEDNj - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- GjEDNj - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1 HYRJJE

Të drejtat e njeriut janë të drejta që u përkasin të gjitha qenieve njerëzore pavarësisht nga raca, gjinia, kombësia, përkatësia etnike, feja, gjuha që ata flasin apo ndonjë statusi tjetër.¹

Nocioni është shfaqur menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, gjegjësisht pas themelimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 1945. Tre vite më vonë, përkatësisht në vitin 1948 është miratuar Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

„Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit në një frymë vëllazërore.“²

Deri më sot, OKB-ja ka zhvilluar një sistem të gjerë standardesh dhe normash ndërkombëtare, si dhe mekanizma për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ekzistojnë mbi 100 akte ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut të cilat rregullojnë të drejta dhe liri të ndryshme themelore.³

Dokumentet juridike ndërkombëtare të OKB-së kanë karakter detyrues. Një mbrojtje më e gjerë sigurohet, ndër të tjerash, përmes Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të viti 1966.⁴

Më 20 shtator 1993, Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore miratoi vendimin për aderimin e vendit në dokumentet juridike ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të miratuara nga OKB-ja . Me këtë vendim, përveç dokumenteve tjera, Republika e Maqedonisë së Veriut që nga viti 1993 ka aderuar plotësisht në Paktin Ndërkombëtar

¹ Marrë nga: <https://www.un.org/en/global-issues/human-rights>.

² Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, i disponueshëm në gjuhën maqedonase në: https://unicode.org/udhr/d/udhr_mkd.html.

³ Faqe 21, <https://www.osce.org/files/f/documents/7/0/385947.pdf>.

⁴ Ibid.

⁵ Vendimi është publikuar më 23.09.1993 në "Gazeta Zyrtare" nr. 57/1993.

për të Drejtat Civile dhe Politike (miratuar më 16.02.1966, ndërsa ratifikuar nga ish – RSFJ më 30.11.1971). Në vitin 1994, R.M.V. ka aderuar në Protokollin e Parë Fakultativ të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (i cili rregullon mundësinë e parashtrimit të ankesës individuale pranë Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, më poshtë: Komiteti), ndërsa në vitin 1995 u bë pjesë e Protokollit të Dytë Fakultativ të Paktit (që synon heqjen e dënimit me vdekje).⁶

Ky doracak bazohet në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe në Protokollin e Parë Fakultativ i cili përcakton mundësinë e çdo individi për të parashtruar ankesë individuale pranë Komitetit. Doracaku ka për qëllim ofrimin e udhëzimeve dhe hapave të thjeshtë të veprimit në procedurën e parashtrimit të ankesës individuale pranë Komitetit. Njëkohësisht, ka për qëllim të shërbejë edhe si material edukativo- informativ për promovimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ky doracak është hartuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (MD) dhe Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj (ShMJR) në kuadër të një memorandumi të lidhur bashkëpunimi dhe i njëjti është si rezultat i përkushtimit të përbashkët për promovimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe realizimin e parimit të sundimit të ligjit.

⁶ Lista e vendeve aderuese në dokumentet e OKB-së, shih në: <https://indicators.ohchr.org/>.

2

PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

2.1. Informacion bazë mbi Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (më poshtë: Pakti) është një traktat shumëpalësh i miratuar më 16 dhjetor 1966, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, i njohur si Rezoluta 2200A (XXI) dhe i hyrë në fuqi më 23 mars 1976. Ky pakt është pjesë e Kartës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, së bashku me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.

Ideja për krijimin e një pakti të tillë i ka rrënjët në vitin 1945, gjegjësisht në Konferencën e San Franciskos ku ishte propozuar "Deklarata për të Drejtat Themelore të Njeriut", e cila çoi në themelimin e Kombeve të Bashkuara, ndërsa Këshillit Ekonomik dhe Social iu dha detyra për ta hartuar të njëjtën. Në fillim të procesit, dokumenti ishte i ndarë në një "deklaratë" ku ishin të përfshira parimet e përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe në një "konventë apo pakt" e cila përmbante angazhimet detyruese. Në vitin 1948, dokumenti evoluoi në Deklaratë Universale për të Drejtat e Njeriut. Procesi i hartimit të konventës vazhdoi tutje, por mbeten dallime të rëndësishme midis anëtarëve të OKB-së në lidhje me rëndësinë relative të të drejtave negative civile dhe politike përkundrejt të drejtave pozitive ekonomike, sociale dhe kulturore. Këto dallime përfundimisht bënë që konventa të ndahej në dy pakte të veçanta, me çrrastë njëri të përmbajë të drejta civile dhe politike, ndërsa tjetri ato ekonomike, sociale dhe kulturore.

Të dy paktet u dërguan për diskutim në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në vitin 1954 ndërsa u miratuan në vitin 1966. Së bashku me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, konsiderohen si tekste bazë të sistemit bashkëkohor ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Për nga struktura, përmbajtja është e njëjtë me atë të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe përbëhet nga preambula dhe 53 nene të ndara në 6 kapituj ku janë të përfshira të drejtat dhe liritë kryesore dhe të njëjtat paraqesin thelbin e dokumentit.

2.2. Të drejtat e parashikuara në Pakt

Të drejtat e parashikuara në këtë Pakt janë të ndara në tri grupime:

2.2.1. Grupimi i të drejtave që përfshijnë marrëdhëniet kyçe midis individit, ekzekutivit dhe sistemit të drejtësisë:

- ***E drejta për të njohur dhe respektuar të drejtat e përcaktuara në Pakt***

Çdo person që ndodhet në territorin e shtetit palë të këtij Pakti ka të drejtë që shteti t'i sigurojë dhe respektojë të drejtat e njohura nga ky Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo sociale, pasuri, lindje apo çdo gjendjeje tjetër. Kjo e drejtë përfshinë gjithashtu mundësin e një mjeti juridik efektiv, aksesin në një procedurë gjyqësore apo administrative në të cilën vendoset për të drejtat e personit, si dhe një garanci që vendimi pozitiv i autoriteteve të ekzekutohet në përputhshmëri.

- ***E drejta për ankim në rast të shkeljes së ndonjë të drejte të garantuar në Pakt***

Të gjitha shtetet nënshkruese të këtij Pakti garantojnë të drejtën e ankimit si mbrojtje ligjore në rast të shkeljes së të drejtave të individit, të garantuara në këtë Pakt.

- ***E drejta e jetës***

E drejta e jetës është e drejtë e lindur e njeriut. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta. Në vendet ku nuk është hequr dënimi me vdekje, ai mund të shqiptohet vetëm për krimet më të rënda në bazë të një aktgjykimi përfundimtarë nga një gjykatë kompetente. Dënimi me vdekje nuk mund të shqiptohet për krime të kryera nga personat nën 18 vjeç. Çdo i dënuar me vdekje ka të drejtë të kërkojë falje ose zëvendësimin e dënimit.

- ***E drejta e trajtimit human dhe dinjitoz***

Kjo e drejtë nënkupton se askush nuk guxon ti nënshtrohet torturës dhe as dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore e poshtëruese, apo të përdoret si eksperiment mjekësor ose shkencor pa pëlqimin e tij të lirë.

• *E drejta e lirisë*

Secili gëzon të drejtën e lirisë. Kjo nënkupton se askush nuk mund të jetë objekt i një arrestimi arbitrar apo në çfarëdo mënyrë të privohet nga liria. Çdo privim i lirisë duhet të jetë në përputhje me ligjin. Çdo person i privuar nga liria duhet të informohet për arsyet e privimit nga liria, të nxirret përpara një gjykatësi i cili do ta zhvillojë gjykimin ose të lirohet. Çdo person i privuar nga liria ka të drejtë ankimi lidhur me ligjshmërinë e masës së ndalimit. Të gjithë personat e privuar nga liria duhet të trajtohen në mënyrë humane dhe dinjitoze. Personat e akuzuar duhet të ndahen nga personat e dënuar gjatë privimit të lirisë. Të miturit e akuzuar duhet të ndahen nga të rriturit e akuzuar dhe të dënuar.

Kjo gjithashtu nënkupton se askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose robëri, të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë apo të jetë viktimë e tregtisë me njerëz.

• *E drejta për një proces të rregullt gjyqësor*

Të gjithë janë të barabartë para gjykatave dhe kanë të drejtë që çështjet e tyre të trajtohen me paañesi dhe publikisht brenda një afati të arsyeshëm kohor. Secili person i cili silllet pranë një gjykate ose në një procedurë të natyrës penale- juridike apo civilo- juridike ka të drejtën e trajtimit të drejtë nga gjykata dhe kjo e drejtë përfshinë garanci minimale gjatë procedurës (p. sh. Të informohet në mënyrë të hollësishme lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës së ngritur kundër tij; të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tij apo të caktuar sipas detyrës zyrtare; të jetë i pranishëm gjatë procesit; të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sillen në gjyq e të merren në pyetje dëshmitarët e mbrojtjes në emër të tij, të mos shtrëngohet të dëshmojë kundër vetvetes etj.). Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale ka të drejtë të kërkojë që shpallja e tij fajtor dhe dënimi i tij të shqyrtohet nga një instancë tjetër gjyqësore më e lartë. Secili person i gjykuar gabimisht që ka vuajtur dënimin ka të drejtë të dëmshpërblehet dhe i njëjti nuk mund të ndëshkohet për një vepër për të cilën është dënuar më parë.

• *E drejta e mosdiskriminimit*

Të gjithë janë të barabartë pavarësisht racës, gjinisë, ngjyrës, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinion tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo statusi tjetër. Kjo barazi vlen edhe para ligjit dhe gjykatave.

2.2.2. Grupimi i të drejtave të cilat sqarojnë pozicionin e individit në shoqëri

- *E drejta e vetëvendosjes*

Çdo popull i cili jeton në territorin e një shteti të caktuar ka të drejtën për të vendosur për gjithçka që ndodh në atë territor. Kjo përfshinë, mes tjerash, të drejtën e popujve për të vendosur mbi zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, përdorimin e resurseve natyrore etj.

- *E drejta e privatësisë*

Secili ka të drejtën e privatësisë. Ndalohet ndërhyrja arbitrare dhe e paligjshme në jetën private, në familje, shtëpi ose letërkëmbim.

- *E drejta e familjes dhe martesës*

Familja është njësi e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe është e mbrojtur nga shteti. Secili ka të drejtën për tu martuar dhe për të formuar familje pas një moshe të caktuar, me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve të ardhshëm.

- *E drejta e fëmijës*

Çdo fëmijë, pa asnjë dallim, ka të drejtën e familjes dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shteti. Çdo fëmijë duhet të regjistrohet në regjistrin e gjendjes civile dhe të ketë një emër. Çdo fëmijë ka të drejtën e një shtetësie.

- *Të drejtat e minoriteteve*

Minoritetet mund të jenë pakica etnike, fetare ose gjuhësore. Personat që iu përkasin këtyre pakicave kanë të drejtë të krijojnë bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit, si dhe të zhvillojnë jetën e tyre kulturore dhe fetare, si dhe të përdorin gjuhën e tyre.

2.2.3. Grupimi i të drejtave të cilat përfshijnë të drejtat dhe liritë themelore:

- ***E drejta e lëvizjes së lirë***

Secili ka të drejtë të lëviz lirshëm brenda territorit të shtetit të tij, si dhe të zgjedhë lirshëm vendbanimin e tij. Secili është i lirë ta braktis shtetin e tij dhe të kthehet përsëri, si dhe lirshëm të vizitojë shtete të tjera. Të drejtat e sipërpërmendura mund të kufizohen vetëm kur kjo parashikohet me ligj.

- ***Të drejtat e të huajve në rast dëbimi***

Një i huaj që ndodhet ligjërisht në territorin e një shteti palë të këtij Pakti mund të dëbohet nga ai shtet vetëm sipas vendimit të marrë në bazë të ligjit. Atij duhet t'i jepet mundësia të parashtojë arsyet kundër dëbimit dhe të kërkojë shqyrtimin e çështjes së tij nga një organ kompetent. Në lidhje me këtë çështje, i huaji ka të drejtë të caktojë një përfaqësues të tij.

- ***E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë***

Secili ka të drejtë t'i përmbahet bindjes së tij dhe ta shprehë atë lirshëm, publikisht dhe privatisht. Secili ka të drejtë të zgjedhë besimin dhe bindjen e tij, si dhe t'i shfaqë ato në mënyrë të pavarur dhe/ose së bashku me të tjerët. Ndalohet imponimi i çfarëdo mendimi apo besimi.

- ***E drejta e lirisë së shprehjes***

Kjo e drejtë ngërthen në vetvete lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, qoftë me gojë apo me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, apo në çfarëdo mënyrë tjetër të zgjedhur prej tij. Ndalohet propaganda luftarake, si dhe çdolloj propagandë tjetër që nxit urrejtje. Ndalohet gjithashtu çdolloj thirrjeje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi dhe dhunë.

- ***E drejta për tu mbledhur***

E drejta për tu mbledhur u mundëson individëve të organizohen dhe të bashkohen për të vepruar me qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta, siç janë politika, sporti,

kultura, qëllime humanitare etj. Kjo e drejtë përfshinë gjithashtu të drejtën për të krijuar sindikata, për tu anëtarësuar në ato etj.

• *E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur*

Kjo e drejtë u ofrohet ekskluzivisht qytetarëve të vendit dhe konsiston në mundësin dhe të drejtën për të marrë pjesë në menaxhimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm; të votojë dhe të zgjedhet në zgjedhje të barabarta dhe të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; të pranohet, në kushte barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

2.3. Protokollin Fakultativ i Paktit i cili rregullon procedurën e parashtrimit të ankesave individuale pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut në OKB

Protokollin fakultativ (më poshtë: Protokollin apo Protokollin Fakultativ) ka hyr në fuqi më 23 mars 1976. Me miratimin e këtij Protokollin, Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka autoritetin për të marrë në shqyrtim ankesat me shkrim që vijnë nga individë të cilët pretendojnë se janë viktimat të shkeljeve të të drejtave të parashikuara në këtë Pakt.⁷

Çdo shtet palë e këtij Protokollin Fakultativ njihet këtë kompetencë të Komitetit, që do të thotë se në rast ankesa individuale është parashtruar nga një qytetarë i një shteti që nuk është palë e këtij Protokollin, Komiteti nuk është i obliguar ta shqyrtojë atë.⁸ Protokollin Fakultativ është vullnetar dhe është i hapur për aderim për çdo shtet që ka nënshkruar Paktin.⁹ Përveç kësaj, çdo shtet palë mund edhe të tërhiqet nga Protokollin Fakultativ përmes njoftimit me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Njoftimi për tërheqje nga Protokollin konsiderohet i vlefshëm tre muaj nga data e pranimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.¹⁰

Rregulli bazë për parashtrimin e ankesave individuale pranë Komitetit, që është edhe parakusht për parashtrimin e ankesës, është i paraparë në nenin 2 të Protokollit. Sipas dispozitave të këtij neni, individët duhet të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike vendase në dispozicion. Një përjashtim nga ky rregull parashihet në nenin 5, paragrafi 2, pika b) të Protokollit, d.m.th. në rastet kur është arsyetuar qartë se zbatimi i mjeteve juridike është vonuar në mënyrë të pajustificueshme. Kusht shtesë për parashtrimin e ankesës individuale është që çështja të mos jetë shqyrtuar në një instancë tjetër hetimi apo shqyrtimi ndërkombëtar (neni 5, paragrafi 2, pika a e Protokollit).

⁷ Preambula e Protokollit Fakultativ

⁸ Neni 1 i Protokollit Fakultativ

⁹ Neni 8, paragrafi 1 i Protokollit Fakultativ

¹⁰ Neni 12, paragrafi 1 i Protokollit Fakultativ

2.4. Komiteti për të Drejtat e Njeriut

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut është një organ i përbërë nga 18 ekspertë¹¹, të pavarur dhe të spikatur në fushën e të drejtave të njeriut. Ekspertët zgjidhen për një mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhjeje.

Komitet punon në seanca, zakonisht mblidhet 3 herë në vit në Gjenevë.

Komitetit kryen monitorimin e zbatimit të Paktit nga shtetet palë përmes raporteve të rregullta të paraqitura prej tyre me kërkesë të Komitetit.¹² Komiteti shqyrton raportet e paraqitura nga shtetet palë të këtij Pakti. Raportet e Komitetit së bashku me vërejtjet e përgjithshme u dërgohen shteteve palë. Sipas nenit 41 të Paktit Fakultativ, Komiteti shqyrton dhe vendos në lidhje me ankesat e paraqitura ndërshtetërore. Protokollin Fakultativ i Paktit i jep Komitetit juridiksion për të shqyrtuar ankesat individuale në lidhje me shkeljet e dispozitave të Paktit nga shtetet palë.¹³ Komiteti gjithashtu publikon interpretimet e tij në lidhje me përmbajtjen e dispozitave të të drejtave të njeriut, të njohura si komente të përgjithshme për çështje tematike ose metodike të punës.¹⁴

Funksioni i Komitetit është të inkurajojë çdo shtet anëtarë:

- Të miratojë ose avancojë ligje, politike dhe praktika të cilat përmirësojnë ushtrimin e të drejtave të njeriut;
- Të tërheqë ose modifikojë masat të cilat janë të dëmshme për të drejtat e parapara me këtë Pakt;
- Të ndër marrë veprime të duhura në rast të dështimit për të promovuar apo mbrojtur këto drejta, etj.

¹¹ Aktualisht, Komitetin e përbëjnë ekspert nga: Paraguai, Egjipti, Tunizi, Guineja, Maroku, Japonia, Spanja, Kanadaja, Uganda, Greqia, Kili, Sllovenia, Portugalia, Koreja, Togo, Franca, Etiopia dhe Shqipëria (për më shumë: <https://www.ohchr.org/en/node/33623/membership>).

¹² Më shumë informacion në lidhje me monitorimin periodik të zbatimit të Paktit mund të gjeni në: <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/ccpr/reporting-procedure>.

¹³ Komiteti ka një praktikë të pasur në trajtimin e ankesave individuale, vendimet e të cilave mund t'i gjeni në: <https://juris.ohchr.org/en/search/results?Bodies=8&sortOrder=Date>.

¹⁴ Komentet e përgjithshme të Komitetit mund t'i gjeni në: <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/ccpr/general-comments>.

3 MODEL, FORMULARI I ANKESËS INDIVIDUALE

3.1. Elementet që duhet të përmbajë ankesa

Ankesa është një dokument me shkrim në të cilin parashtruesi përshkruan shkeljet e të drejtave nga ana e shtetit, e të cilat janë të parapara me këtë Pakt. Në përgjithësi, ankesa duhet të përmbajë informacione elementare për parashtruesin (dhe përfaqësuesin e tij) dhe shtetin kundër të cilit është parashtruar ankesa; sqarim të fakteve dhe arsyet e parashtrimit; detaje në lidhje me masat e shfrytëzuara për të mbrojtur të drejtën sipas legjislacionit vendas; listën e provave të bashkangjitura, pra kopje të dokumenteve si mbështetje për faktet dhe argumentet e paraqitura në ankesë.¹⁵

3.1.1. INFORMACIONET BAZË PËR PARASHTRUESIN DHE SHTETIT NDAJ TË CILIT PARASHTROHET ANKESA

Si informacion bazë, rekomandohet të shënohet emri dhe mbiemri i parashtruesit, i cili pretendon se shteti ka bërë shkelje të të drejtave të Paktit, nacionalitetin, datën e lindjes, adresa e banimit, e-mail adresën, si shteti ndaj të cilit është bërë ankesa. Nëse gjatë procedurës ka ndryshim në këto të dhëna (pas parashtrimit të ankesës) është e nevojshme që sa më shpejt të jetë e mundur të informohet Komiteti.

Parashtruesi (i cili zakonisht është dhe viktimi e shkeljes së të drejtave nga ana e shtetit) mund të përfaqësohet një person tjetër, pra ankesa të parashtrohet nga personi tjetër në emër dhe për llogari të parashtruesit. Në këtë rast, parashtruesi duhet të jap pëlqimin e tij (autorizim) mirëpo nëse kjo nuk është e mundur, personi përmes së cilit parashtrohet ankesa (zakonisht i referohet si „autor i ankesës,“) duhet të shpjegojë përse është parashtruar ankesa përmes atij/asaj dhe përse pajtueshmëria (autorizimi) e parashtruesit nuk mund të dorëzohet/parashtrohet (si p.sh nëse ankesa e dorëzuar është në emër të personit që është në burg). Nuk është e nevojshme që ankesa të dërgohet përmes avokatit, edhe pse këshillat juridike do të përmirësojnë cilësinë e ankesës. Ndiurma juridike e avokatit nuk është e parapare gjatë procedurës pranë Komitetit.

Nëse ankesa përfshin veçanërisht informacione të ndjeshme private dhe profesionale, parashtruesi mund të kërkojë që me vendimin e Komitetit të mos publikohen emri i atij/asaj apo çfarëdolloj tjetër informacioni personal.

¹⁵ Si burim i tekstit nga pika 4.1 (dhe nënpikat e këtij teksti) është shfrytëzuar informacioni i publikuar në: <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/individual-communications#overviewprocedure>.

Komiteti, gjithashtu ka të drejtë në mënyrë të pavarur të vendos që të mos publikohen informacione të njëjta apo të ngjashme, edhe kur kjo nuk është kërkuar dhe qartë e theksuar në ankesë

3.1.2 PËRSHKRIMI I FAKTEVE DHE ARGUMENTEVE NË TË CILAT BAZOHET ANKESA

Të gjitha faktet dhe argumentet në të cilat bazohet ankesa duhet të parashtrihen dhe të shpjegohen në mënyrë kronologjike.

Kjo pjesë e ankesës rekomandohet të jetë më e detajuar dhe të përmbajë informacione relevante për rastin konkret, gjegjësisht për shkeljen e të drejtës konkrete të kryer nga ana e shtetit. Kjo do të thotë se parashtruesi ankesës duhet të sqarojë faktet e përshkruara dhe argumentet e parashtruara që quan deri tek shkelja e të drejtës.

Në këtë kontekst, rekomandohet të identifikohen me saktësi të drejtat e Paktit për të cilat pretendohet se janë shkelur. Gjithashtu rekomandohet të përshkruhet lloji i mjeteve juridike të cilat parashtruesi synon t'i fitojë nga ana e shtetit në rast se Komiteti konstaton se faktet e parashtruara në ankesë paraqesin shkelje të të drejtave të parashtruesit.

3.1.3. SHFRYZËIMI I TË GJITHA MJETEVE LIGJORE VENDASE

Parashtruesi i ankesës duhet që në detaje të përshkruaj të gjitha veprimet e ndërmarra për të shterur të gjitha mjetet juridike dhe procedurat e disponueshme sipas ligjeve nacionale. Këtu përfshihen të gjitha paditë, ankesat, peticionet dhe iniciativat pranë gjykatave vendase (në çfarëdo instance dhe juridiksioni) dhe institucioneve tjera kompetente.

Shfrytëzimi i të gjitha mjeteve ligjore të vendase dhe mekanizmave për mbrojtje nënkupton se kërkesat për mbrojtje (ushtrim) të të drejtës duhet të paraqiten domosdoshmërisht pranë autoriteteve kompetente dhe përkatëse nacionale/vendase. Nëse edhe pas parashtrimi të mjeteve juridike ende nuk ka vendim, gjegjësisht çështja është ende në procedim, ose thjesht mjetet juridike nuk janë ezauruar/shfrytëzuar, kjo duhet të shpjegohet në këtë pjesë të ankesës, gjegjësisht të sqarohet arsyeja se pse e njëjta nuk është realizuar.

Në këtë pjesë të ankesës, gjithashtu, parashtruesi duhet të sqarojë nëse ka paraqitur ankesë në ndonjë instancë tjetër për mbrojtje ndërkombëtare.

3.1.4. FOTOKOPJET E DOKUMENTEVE –DËSHMIVE PËRKATËSE

Ankesa duhet të përmbajë dëshmi si mbështetje për faktet dhe argumentet e paraqitura, të cilat duhet të jenë ekskluzivisht kopje (jo origjinal). Dëshmitë duhet të përbëhen nga vendime gjyqësore/ apo institucione përkatëse. Nëse dëshmitë janë në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të OKB-së, atëherë duhet të përkthehen pjesët me thelbësore të tyre (apo të përkthehen dokumentet në tërësi).

Gjuhët oficiale të OKB janë: gjuha arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle. Çdo dokument i dorëzuar si dëshmi duhet të jetë i rregulluar në mënyrë kronologjike, sipas datës, me numër të arshivës si dhe përshkrim konciz për përmbajtjen e tij.

Ankesa nuk duhet të përmbajë më shumë se 50 faqe (pa numëruar dokumentet e bashkangjitura). Nëse ankesa ka më shumë se 20 faqe, e njëjta duhet të ketë përmbledhje të shkurtër jo më të gjatë se 5 faqe në të cilat duhet të theksohen elementet kryesor të ankesës.

Nëse ankesa përmban disa informacione thelbësore, pa të cilat nuk mund të veprohet apo nëse përshkrimi i fakteve është i paqartë, Sekretariati i Kombeve të Bashkuara (Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut - Office of the High Commissioner for Human Rights – OHCHR) do të kontaktoj parashtruesin e ankesës të dorëzoj detaje dhe informacione plotësuese apo të ri paraqesë dëshmitë.

Nëse do të nevojiten dëshmi dhe sqarime shtesë, parashtruesi i ankesës duhet ti përgjigjet kërkesës në afat sa më të shkurtër, më së voni në afat prej 1 viti. Në raste se informacionet, dëshmitë dhe sqarimet e kërkuara nuk dorëzohen në afat brenda 1 viti nga dita e parashtrimin të kërkesës, çështja do të mbyllet.

3.2. ADRESA E KOMUNIKIMIT

Ankesa dorëzohet deri te Komiteti për të drejtat e njeriut në adresën në vijim;

Origjina	Përkthim në gjuhën shqipe
Petitions Team	Ekipi për ankesa dhe parashtresa
Office of the High Commissioner for Human Rights	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
United Nations Office at Geneva	Zyra e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë
1211 Geneva 10, Switzerland	1211 Gjenevë 10, Zvicër
Fax: + 41 22 917 9022 (particularly for urgent matters)	Tel. Faks: + 41 22 917 9022 (për raste urgjente)
Email: petitions@ohchr.org	Email adresa: petitions@ohchr.org

3.3. MODEL, FORMULARI I ANKESËS

Ankesat pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut, gjithashtu, njihen edhe si „letër komunikime,, ose „parashtresa,,. Sa i përket ankesës, nuk është i paraparë formular i veçantë, mirëpo rekomandohet të plotësohet formulari i paraqitur në këtë Doracak.

Ankesa duhet të jetë me shkrim, me përmbajtje përshkruese. Nëse shkruhet me dorë, duhet të jetë e lexueshme. Rekomandohet të përpilohet në kompjuter. Komiteti nuk praktikon të pranoj dhe të shqyrtoj ankesë gojore, apo prova audio dhe audiovizuale.

Ankesa duhet të nënshkruhet nga parashtresesi (apo nga personi i cili përfaqëson parashtresin).

Ankesa mund të dorëzohet edhe në mënyrë elektronike në adresën e përmendur në pikën 4.2 të këtij doracaku.

ANKESË

E PARASHTRUAR NË BAZË TË PROTOKOLLIT FAULTATIV TË PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT SOCIALE DHE POLITIKE

Data:

I. INFORMACION BAZË MBI PARASHTRUESIN E ANKESËS (viktimë e shkeljeve):

Emri:; Mbiemri:; Kombësia:; Data dhe vendi i lindjes:; Adresa e banimit (për korrespondencë me shkrim) të parashtruesit të ankesës:
.....;

Parashtrues i ankesës:

(„Viktima“) Nëse parashtruesi përfaqëson veten:;
(„Autori“) Nëse parashtruesi përfaqësohet nga një person tjetër (përfaqësues)
.....;

[Në rast se parashtruesi, gjegjësisht viktima përfaqësohet nga një person tjetër (përfaqësues):

Të shënohen të dhënat e mëposhtme personale të personit përmes së cilit është parashtruar ankesa (përfaqësuesit, përkatësisht autorit të ankesës)

Emri: ; Mbiemri: ; Kombësia:; Data dhe vendi i lindjes:; Adresa e banimit ose e qëndrimit të përkohshëm:

(Për përfaqësuesin, përkatësisht autorin e ankesës) Nëse përfaqësuesi (përkatësisht autori i ankesës) ka parashtruar ankesën me pëlqimin dhe dijeninë e viktimës, të specifikohet dokumenti i autorizimit:

Ose

Nëse nuk ka autorizim me shkrim, të specifikohet natyre e marrëdhënieve me viktimën:

.....
....., përveç kësaj të specifikohen arsyet se përse përfaqësuesi (përkatësisht autori i ankesës) e konsideron të përshtatshme parashtrimin e ankesës në emër dhe për llogari të viktimës:

¹⁶ Formulari është shkarkuar nga: <https://www2.ohchr.org/english/bodies/docs/annex1.pdf>, ndërsa përkthimi nga anglishtja në maqedonisht është bërë nga autorët e këtij doracak. Modeli i formularit të ankesës me të njëjtat elemente është gjithashtu i disponueshëm në: <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/complaints-about-human-rights-violations>.

Deklarata e viktimës me kërkesë të posaçme drejtuar Komitetit për të mos i publikuar të dhënat personale në vendimin e shpallur publikisht:

II. SHTETI QË KA KRYER SHKELJEN/ DISPOZIATAT E PAKTIT NË BAZË TË CILAVE ËSHËTE KRYER SHKELJA

Të shënohet shteti palë i Protokollit Fakultativ:

Të shënohen të drejtat nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat janë shkelur nga shteti:

III. TË PËRSHKRUEHEN MJETET E SHFRYTËZUARA JURIDIKE NACIONALE/ MEKANIZMAT E SHFRYTËZUAR PËR PROCEDURA TË TJERA MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Hapat e ndërmarrë prej apo në emër të viktimës/viktimave në suaza të mundësive ligjore dhe institucioneve legjitime në shtetin i cili ka kryer shkeljen – të sqarohen procedurat e filluara dhe zbatuara; të jepet përshkrim mbi procedurat pranë gjykatave dhe/ose pranë institucioneve kompetente; të sqarohet se çfarë është kërkuar, kur është kërkuar, çfarë dhe si është vendosur dhe me cilin vendim:

Në rast se nuk janë të shfrytëzuara të gjitha mjetet juridike të parapara me legjislacionin vendas sepse kjo do të ndikonte në zvarritjen e pajustificuar të procedurës, apo nëse të njëjtat nuk konsiderohen si efektive, apo nëse ato nuk kanë qenë të disponueshme për viktimën, apo nëse ekzistojnë arsye të tjera, të sqarohet dhe arsyetohet në detaje se cilat janë ato arsye:

A keni dorëzuar të njëjtën çështje për shqyrtim në një procedurë ndërkombëtare si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (si p.sh. procedurë pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, etj.)

Në rast se është iniciuar një procedurë e tillë, të specifikohet procedura e ngritur, cilat janë kërkesat e bëra, kur është iniciuar, a është vendosur dhe cili është përfundimi:

IV. FAKTET DHE ARGUMENTET MBI TË CILAT ËSHTË E BAZUAR ANKESA

Të përshkruhen në detaje dhe sipas rendit kronologjik faktet dhe rrethanat e shkeljeve të pretenduara. Të përfshihen të gjitha detajet të cilat janë apo mund të jenë të rëndësishme për të vlerësuar apo marrë në konsideratë çështjen konkrete. Ju lutemi shpjegoni se si faktet dhe rrethanat e prezantuara cenojnë të drejtat tuaja:

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....;

Nënshkrimi i parashtruesit të ankesës (viktimës, përkatësisht autorit të ankesës):

.....
.....;

*[Hapësirat e zbrazëta nën seksioneve të këtij formulari paraqesin hapësirën ku duhet shënuar përgjigjet sipas udhëzimeve të dhëna në formular. Ju mund të shfrytëzoni aq hapësirë sa ju nevojitet për të shënuar përgjigjet.

V. LISTA KONTROLLUESE E DOKUMENTACIONIT MBËSHTETËS

(Të dorëzohen vetëm kopje, jo dokumente origjinale)

- Autorizimi (nëse po bëni ankesë në emër të një personi tjetër);
- Vendimet (aktgjykimet, vendimet, konkluzionet, etj.) e gjykatave dhe autoriteteve vendase (një kopje e legjislacionit vendas do të ishte e dobishme);
- Ankesat e parashtruara dhe vendimet e marra nga procedurat e ngritura për mbrojtje ndërkombëtare;
- Dokumente të tjera (ose prova) të cilat i posedon parashtruese i ankesës, mbi të cilat mbështetet përshkrimi në Pjesën IV në lidhje me faktet dhe argumentet e cenimit të të drejtës.

4

PROCEDURA

E VENDIMMARRJES SË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT, NË LIDHJE ME ANKESAT INDIVIDUALE

4.1. Kushtet e parashtrimit të ankesave individuale

Ankesa duhet të parashtrohet nga personi ndaj të cilit është bërë shkelja apo nga një person tjetër i autorizuar për të vepruar në emër të tij. Komiteti është i kufizuar për të shqyrtuar një çështje që tashmë është hetuar dhe trajtuar në një procedurë tjetër hetimi ndërkombëtar.

Kushtet që duhet plotësuar për parashtrimin e ankesës individuale:

- Ankesa nuk mund të parashtrohet në mënyrë anonime;
- Ankesa nuk duhet të përbëjë "shpërdorim të së drejtës", që do të thotë se e drejta për të parashtruar ankesë duhet të shfrytëzohet në mënyrë racionale;
- Ankesa duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Paktit;
- Është e domosdoshme që parashtruesi të ketë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike vendase në dispozicion.¹⁷

4.2. Procedura

4.2.1. Afati i parashtrimit të ankesës

Është e rëndësishme që ankesa të parashtrohet sa më shpejtë që të jetë e mundur, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike nacionale. Parashtrimi i vonuar i ankesës mund ta bëjë më të vështirë për Shtetin që të përgjigjet në mënyrë adekuate, por edhe ta bëjë më të vështirë për Komitetin që të shqyrtojë plotësisht dhe në mënyrë të detajuar situatën faktike të deklaruar në ankesë. Në disa raste, një ankesë e vonuar mund të rezultojë në shpallje të rastit si të papranueshëm, siç edhe thuhet në mënyrë specifike në Rregulloren e Punës së Komitetit për të Drejtat e Njeriut, dispozita 99 (c)¹⁸. Sipas kësaj dispozite "ankesa do të konsiderohet e vonuar në rast se është parashtruar pas 5 viteve nga koha e shterimit të të gjitha mjeteve juridike vendase apo, nëse kanë kaluar 3 vite nga përfundimi i ndonjë procedure tjetër ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë arsyeje të tjera që justifikojnë një vonesë të tillë".

¹⁷ Kushtet për parashtrimin e ankesave individuale janë marrë nga: http://www.claiminghumanrights.org/ccpr_individual_communications.html, ndërsa janë të përkthyer nga ana e autorëve të këtij dokumenti.

¹⁸ Rules of procedure of the Human Rights Committee, CCPR/C/3/Rev.12, 4 janar 2021, I disponueshëm në gjuhën angleze: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CCPR%2fC%2f3%2fRev.12&Lang=en.

4.2.2. Procedura pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut

Komiteti shqyrton ankesat në seanca të mbyllura.

Pas pranimit dhe regjistrimit të ankesës, ajo i përcillet Shtetit me çrrastë i kërkohet të përgjigjet brenda një afati të caktuar. Pas marrjes së përgjigjes, ajo i përcillet parashtruesit të ankesës duke i dhënë mundësinë që të bëjë komentin e tij mbi përgjigjen e Shtetit. Pas kësaj, vijon procesi i vlerësimit të pranueshmërisë dhe bazueshmërisë së lëndës.

Në situata të caktuara mund të ndodhë që Komiteti të vendosë që fillimisht ta vlerësojë pranueshmërinë. Në rast se vlerësimi është pozitiv, Komiteti i bën thirrje Shtetit për të dhënë përgjigje mbi bazueshmërinë e pretendimeve që më pastaj përgjigjen nga Shteti t'ia përcjell parashtruesit të ankesës për të dhënë komentin e tij.

Më pas, Komiteti vendosë mbi ankesën e parashtruar. Vendimi i dorëzohet njëkohësisht parashtruesit dhe shtetit. Një apo më shumë anëtarë të Komiteti mund të kenë mendime të ndryshme në raport me çështjen apo shumica mund të ketë mendim të njëjtë por duke u thirrur në arsye të ndryshme. Teksti i vendimit final mbi bazueshmërinë e ankesës apo vendimit mbi pranueshmërinë e ankesës, publikohet në ueb-faqen e Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), si pjesë e praktikës së Komiteti.

4.2.3. Çfarë ndodhë pasi Komiteti vendos mbi ankesën?

Vendimet e marra nga Komiteti janë përfundimtare, që do të thotë se vendimet nuk mund të ankimohen. Se çfarë ndodhë me një lëndë të caktuar varet nga natyra e vendimit.

NËSE KA SHKELJE – në rast se Komiteti, në bazë të fakteve dhe argumenteve të prezantuara në ankesë, konstaton se ka shkelje të dukshme, atëherë i bën thirrje Shtetit që të paraqesë informacion brenda 180 ditëve mbi hapat që do ti ndërmerr për t'i zbatuar rekomandimet e Komitetit. Informacioni nga Shteti i dorëzohet edhe parashtruesit të ankesës.

NËSE NUK KA SHKELJE – në rast se Komiteti nuk konstaton shkelje të së drejtës së pretenduar, apo nëse vendos se ankesa është e papranueshme, atëherë çështja mbyllet.

Vendimet e Komiteti konsiderohen edhe si një lloj interpretimi të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Ato përmbajnë gjithashtu rekomandime drejtuar shteteve. Komiteti ka të zhvilluara edhe procedura të mbikëqyrjes dhe vëzhgimit të Shtetit për sa i përket zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Komiteti është i mendimit se me pranimin e procedurave, shteti ka pranuar edhe respektimin e gjetjeve të Komitetit. Në rast se shteti nuk ndërmerr veprimet e nevojshme, çështja konsiderohet e hapur. Gjatë kësaj periudhe, Komiteti inicion dhe zhvillon dialogë me Shtetin deri në marrjen e masave dhe veprimeve të nevojshme nga shteti. Informacionet në lidhje me dialogun e zhvilluar nuk janë të klasifikuara, përkatësisht konsiderohen publike.

5 RASTE

5.1 S.I.D. et al. v. Bulgaria No. 1926/2010

RËNDËSIA E RASTIT:

Objekt i këtij rasti¹⁹ është dëbimi dhe rrënimi i banesave (shtëpive) të personave të komunitetit rom, të cilët kanë jetuar për shumë vite në një komunë të R. Bullgarisë. Çështjet thelbësore kanë të bëjnë me aksesin në një ankesë efektive, gjegjësisht mjetë juridik; ndërhyrje arbitrare dhe të paligjshme në shtëpi; e drejta për barazi para ligjit/mbrojtje të barabartë sipas ligjit; diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike, me çrrastë që të gjitha së bashku përbëjnë shkelje të pretenduar të neneve 2, 17 dhe 26 të Paktit, dhe të shqyrtuara në raport me nenin 2 dhe nenin 5, paragrafi 2, pika (a) të Protokollit Fakultativ të Paktit. Për më tepër, nga ky rast mund të kuptojmë se në cilin rast konsiderohet se ekziston një procedurë tjetër hetimi apo zgjidhjeje ndërkombëtare, çfarë nënkupton mbështetja e fakteve me prova adekuate (si çështje procedurale), disa faza të komunikimit midis parashtruesit të ankesës, shtetit dhe Komitetit, si dhe është veçanërisht e rëndësishme që rasti përfshinë mendime të veçanta mospajtimi me vendimin e shumicës, e të cilat janë dhënë nga disa anëtarë të Komitetit.

PËRSHKRIM I SHKURTËR I FAKTEVE DHE SHKELJEVE TË PARAQITURA NË ANKESË:

Parashtrues të ankesës janë persona me kombësi bullgare, të gjithë anëtarë të komunitetit rom, banorë të lagjeve të improvizuara rromë në Gorno Ezerovo, të cilat ekzistojnë për më shumë se 50 vite, si dhe banorë të lagjeve në Meden Rudnik, të cilat ekzistojnë për më shumë se 20 vite.

Me kalimin e viteve, këto komunitete dhe vendbanime kanë qenë të pranuar de facto nga ana e autoriteteve shtetërore në atë mënyrë që banorëve u janë ofruar shërbime postare, ujësjellës, energji elektrike, rrjet kanalizimi etj.

Në vitin 2007, 52 banorë të Gorno Ezerovo dhe 32 familje nga Meden Rudnik morën urdhër dëbim dhe njëkohësisht u morë vendimi për rrënimin e banesave të ndërtuara pa leje. Sipas pretendimeve të parashtruesve të ankesës individuale, dëbimi i tyre ka

¹⁹ Vendimi për rastin S. I. D. et al. v. Bulgaria No. 1926/2010 është i disponueshëm në anglisht në: Jurisprudence (ohchr.org).

ardhur si rezultat i kërkesave të pronarëve privat të truallit në cilin parashtuesit kishin pasur vendbanimin e tyre shumë vite më parë.

Në vitin 2008, personat në fjalë, përmes procedurave të veçanta të vendosura nga Komiteti, kanë parashtuar ankesën e tyre, me çrrastë është ndërpre dëbimi. Në vitin 2009, Komiteti ka pezulluar shqyrtimin e ankesës dhe si pasojë ka filluar dëbimi i tyre me asistencë të policisë lokale. Gjatë dëbimit, policia ka përdorur forcë të tepruar, banorët janë dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre dhe disa janë rrahur, duke lënë pas kështu gjërat e tyre personale, përfshirë këtu orenditë të cilat kanë qenë akoma në shtëpitë e tyre në momentin e rrënimit.

Asnjë nga familjet e dëbuara me forcë dhe pa asnjë konsultim paraprak , nuk morri strehim alternativ.

Në atë kohë, nuk kanë ekzistuar mjete juridike efektive nacionale për të kundërshtuar dëbimin. Pavarësisht kësaj, disa familje u përpoqën të dërgonin çështjen në Gjykatë Administrative dhe në Gjykatë të Lartë Administrative. Prapëseprapë, urdhrat e dëbimit mbeten në fuqi për shkak të mungesës së sigurisë mbi juridiksionin e gjykatave. Gjithashtu, në mungesë të bazës ligjore për të banuar në parcelat dhe banesat përkatëse, të gjitha çështjet e ngritura u rrëzuan.

RRJEDHA E PROCEDURËS:

Përgjigjja e shtetit:

Në përgjigjën e dhënë, shteti ka paraqitur vërejtjet e tij dhe i është kërkuar Komitetit shpalljen e ankesës së parashtuar si të papranueshme në përputhje me dispozitat 96 (c), (e) dhe (f) të Rregullores së Punës së Komitetit:

Papranueshmëria sipas dispozitës 96 (c) të Rregullores së Punës: shteti ka vënë në dukje se gjatë vitit 2009, parashtuesit e ankesës kanë bërë kërkesa të ngjashme sipas procedurave të veçanta të Komitetit për të Drejtat e Njeriut, gjegjësisht Raportuesit special për strehim të përshtatshëm si një komponentë e së drejtës për një standard të përshtatshëm jetese dhe, në këtë kontekst, të drejtës për mosdiskriminim; eksperti i pavarur për çështjet e pakicave; Raportuesi special mbi format bashkëkohore të racizmit, diskriminimit racor, ksenofobisë dhe intolerancës. Si rrjedhojë, ankesa duhet shpallur e papërshtatshme për shkak të ekzistencës së një procedure tjetër ndërkombëtare.

Papranueshmëria sipas dispozitës 96 (e) të Rregullores së Punës: kërkesat e bëra sipas procedurave të veçanta të Komitetit, të përshkruara më sipër, kanë qenë të së njëjtës periudhë dhe kjo nënkupton keqpërdorim të së drejtës për parashtim të ankesës.

Papranueshmëria sipas dispozitës 96 (f) të Rregullores së Punës: banorët nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike vendase në dispozicion, përveç tjerash, kjo është në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, pika (b) të Protokollit Fakultativ të Paktit. Mes tjerash, në përgjigjen e dhënë, shteti ka theksuar se mundësia për të legalizuar ndërtimet pa leje sipas ligjit ka ekzistuar prej vitesh dhe se janë rrënuar objektet për të cilin nuk është dorëzuar kërkesë legalizimi deri më 26 janar 2004 apo për të cilët është refuzuar kërkesa për legalizim.

Në këtë kontekst, në opinionin e shtetit thuhet se ndërtimet pa leje të komunitetit të Gorno Ezerovo dhe Meden Rudnik në komunën Burgas, i janë nënshtruar një inspektimi paraprak. Inspektimi ka konstatuar 44 punime ndërtimore pa leje dhe 10 objekte që kanë qenë jashtë kuadrit rregullativ të Gorno Ezero, si dhe 21 ndërtime pa leje dhe 10 njësi ndërtimi në territorin e Meden Rudnik, gjegjësisht në sipërfaqe të tokës komunale të paraparë për rrugë, si dhe në toka private.

Përgjigjja e parashtruesve të ankesës ndaj përgjigjes së shtetit

Parashtruesit kanë kontestuar pretendimet e shtetit mbi papranueshmërinë e ankesës për shkak të procedurës së nisur më parë sipas procedurave të veçanta të Komitetit, ndërsa, nga ana tjetër, lidhur me përdorimin e të gjitha mjeteve juridike vendase, theksojnë se vendimet e Gjykatës Supreme Administrative nuk janë të përshtatshme dhe efektive.

Për më tepër, ata i janë referuar rastit të Naidenova et al. v. Bullgaria Nr. 2073/2011²⁰ me çrrastë kanë konsideruar se arsyetimi i Komitetit për këtë çështje është i zbatueshëm edhe për ankesën në fjalë. Ata kanë konsideruar se shteti, përmes autoriteteve dhe institucioneve përkatëse, duhet të përcaktojë pronësinë e tokës në fjalë, ndërsa nga ana tjetër, mungesa e procedurës për përcaktimin e pronësisë faktike të tokës tregon mungesën e urgjencës në përcaktimin e pronësisë, e që është një dëshmi shtesë se dëbimi ka qenë i panevojshëm dhe nuk është dashur të zbatohet.

Informacion shtesë i kërkuar nga ana e Komitetit

Komiteti i ka kërkuar shtetit të japë sqarime mbi ndërtimet në vendbanimet në Gorno Ezero dhe Meden Rudnik, ndërsa nga parashtruesit e ankesës, ka kërkuar sqarime shtesë dhe paraqitjen e dëshmive për shfrytëzimin e vendbanimeve përmes pagesave komunale.

²⁰ Vendimi është i disponueshëm në gjuhën angleze në: <http://hrlibrary.umn.edu/undocs/2073-2011.html>

VENDIMI I KOMITETIT LIDHUR ME PRANUESHMËRINË E ANKESËS:

Komiteti thekson se **procedurat apo mekanizmat e vendosur nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut, për shqyrtimin dhe raportimin publik të situatës sa i përket të drejtave të njeriut në vende ose territore të caktuara, apo rasteve të shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut në botë, nuk paraqesin një procedurë hetimi apo zgjidhjeje ndërkombëtare në aspekt të nenit 5, paragrafi 2, pika (a) të Protokollit Fakultativ të Paktit.** Prandaj, Komiteti konsideron se ankesa duhet shqyrtuar dhe se e njëjta është e pranueshme.

Për sa i përket shtëpive në këto komunitete, Komiteti ka konstatuar se disa prej tyre janë ndërtuar pak kohë më parë, se janë ndërtuar në tokë private dhe se pronarët e tyre kanë qenë të interesuar për ta rifituar posedimi e tokës.

Nga provat shtesë të cilat Komiteti i ka kërkuar nga parashtruesit e ankesës dhe të cilat kanë të bëjnë me pagesat komunale, është konstatuar se janë dhënë vetëm përgjigje të përgjithësuara. Parashtruesit nuk kanë dhënë sqarime për tokën e uzurpuar, sipas të cilës nuk ka qenë e mundur të përcaktohet me siguri kohëzgjatje e zaptimit të lokacioneve specifike të kontestuara nga ana e parashtruesit. Duke u bazuar në këto rrethana, Komiteti ka ardhur në përfundim se parashtruesit e ankesës **nuk kanë mbështetur mjaftueshëm me prova pretendimet e tyre sipas nenit 17, në lidhje me nenin 2 të Paktit, dhe të njëjtat i konsideron si të papranueshme sipas nenit 2 të Protokollit Fakultativ.**

Sa u përket pretendimeve për shkelje të **nenit 26, në lidhje me nenin 2 të Paktit,** gjegjësisht pretendimeve se shteti nuk ka respektuar parimet e mbrojtjes së barabartë dhe të mos diskriminimit dhe se ka kërcënuar apo kryer dëbime me forcë dhe rrënim të shtëpive të parashtruesve të ankesës për shkak të përkatësisë së tyre etnike, Komiteti konsideron se këto pretendime **nuk janë mjaftueshëm të mbështetura në prova dhe për këtë arsye janë të papranueshme** sipas nenit 2 të Protokollit Fakultativ.

OPINIONE TË PËRZGJEDHURA TË ANËTARËVE TË KOMITETIT

1. Në opinionin e pare, anëtarët e Komitetit nuk bien dakord sa i përket nenit 17 të Paktit, më konkretisht ata nuk janë dakord se nuk kemi të bëjmë me shkelje të këtij neni nga ana e shtetit.

Në këtë opinion theksohet se "Kualifikimi i aktit të dëbimit me forcë si ndërhyrje arbitrare në shtëpitë e tyre sipas nenit 17 të Paktit, nuk varet vetëm nga fakti nëse personat e dëbuar kanë pasur të drejta ligjore, por edhe nga fakti nëse shteti ka marrë parasysh pasojat eventuale gjatë dëbimit të personave në fjalë. Duke marrë parasysh se në disa raste kur kemi të bëjmë me periudha më të gjata qëndrimi në vendbanimet përkatëse, Shtetit palë mund t'i kërkohej që personave të dëbuar t'u ofrohet zgjidhje alternative për strehim afatgjatë. Në raste të tjera, gjegjësisht kur kemi të bëjmë me periudha më të shkurtra qëndrimi, është e mjaftueshme që Shteti të ketë miratuar masa më modeste,

të tilla si ofrimi i zgjidhjeve afatshkurta të strehimit të personave të dëbuar apo t'i shqyrtojë nevojat të tyre në kuadër të programeve të përgjithshme të strehimit social". Rrjedhimisht, anëtarët të Komitetit janë të mendimit se shteti nuk u ka kushtuar vëmendjen e duhur pasojave të dëbimit me forcë, në veçanti, nevojave alternative të strehimit të personave të dëbuar dhe vështirësive unike si pasojë e statusit të tyre, që është një shkelje e rëndë e nenit 17 të Paktit.

2. Opinioni i dytë paraqet mendimin individual të anëtarit të tretë të Komitetit, i cili trajton çështjen e parashtruesve të ankesës në rastin *Naidenova et al. v. Bullgaria* No. 2073/2011, për të cilin rast Komiteti ka konkluduar se " zbatimi i urdhrat të dëbimit të datës 24 korrik 2006, pa u ofruar zgjidhje të kënaqshme alternative të strehimit do të përbënte shkelje të të drejtave të parashtruesve nga ana e shtetit".

Për më tepër, Komiteti, në komentin e tij të përgjithshëm të nenit 17, thekson se edhe kur dëbimi me forcë parashikohet me ligj, si në rastin konkret, ai nuk duhet të jetë arbitrar dhe se në rrethana të caktuara duhet të jetë i arsyeshëm sipas dispozitave dhe objektivave të Paktit. Konkluzionet e Komitetit tregojnë qartë se dëbimet me forcë, Shtetet palë duhet t'i zbatojnë vetëm pasi të jenë konsultuar me personat e prekur dhe pasi të janë gjetur plane alternative të strehimit, e të cilat në rastin konkret mungojnë.

Gjithashtu, ky opinion i është referuar edhe një rasti të ngjashëm, *Jordanova dhe të tjerët kundre Bullgarisë* (25446/06), në lidhje me të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kishte vendosur unanimisht duke identifikuar qartë problemin e mungesës së sigurisë juridike. Në këtë rast, gjykata është e mendimit se dëbimi me forcë i një komuniteti të vjetër rom do të përbënte shkelje të dispozitave ligjore sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Anëtar i Komitetit i cili jep këtë opinion kundërshtues, nenin 8 të KEDNJ e konsideron si ekuivalent me nenin 17 të Paktit.

5.2. Marija and Dragana Novaković v. Serbia No. 1556/2007

RËNDËSIA E RASTIT²¹:

Ankesa është dorëzuar nga të afërmit (parashtuesit e ankesës) e personit mbi të cilin është ushtruar dhunë sipas dispozitave të Paktit (viktimitës). Çështja thelbësore është e drejta e jetës dhe mungesa e mjetit juridik adekuat, që paraqet shkelje e pretenduar e nenit 6 dhe 2 në lidhje me nenin 6 të Paktit.

PËRSHKRIM I SHKURTËR I FAKTEVE DHE LENDIMEVE TË PËRMENDUR NË ANKESË:

Viktima është pranuar në Klinikën për kirurgji maksilofaciale në Beograd më 24 Mars të vitit 2003 dhe pastaj është transferuar në Klinikën për sëmundje infektive. Të dy spitalet janë pronë shtetërore. Më 30 Mars të vitit 2003, viktima ka nderuar jetë si pasojë e një inflamacioni purulent në goje, qafë, gjoks dhe komplikime të tjera të vazhdueshme. Që nga paraqitja e infeksionit, dhëmbi nuk është hequr, analizat e përgjithshme siç është analiza mikrobiologjike asnjëherë nuk është bërë si dhe trajtimi kirurgjik i aplikuar nuk ka qenë i mjaftueshëm. Duke u bazuar në dokumentet, siç është ekspertiza pas vdekjes së viktimit, raportet dhe mendimet e ekspertëve të mjekësisë ligjore, konstatojnë se mjekët që kanë trajtuar z.Novkoviç në të dy spitalet janë përgjegjës për lëshime serioze dhe gabime gjatë trajtimit mjekësor, që ka shkaktuar përkeqësim të gjendjes shëndetësore e cila ka rezultuar me vdekje.

Më 2 tetor 2003, parashtuesit paraqitën një raport në Prokurorinë e Beogradit në lidhje me vdekjen, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm. Prokuroria ka nisur hetimet ndaj autorëve të panjohur, pavarësisht se në atë kohë prokuroria i njihte emrat e mjekëve që mjekonin viktimit. Legjislacioni i brendshëm parashikonte që ndjekja penale e krimeve të sipërpërmendura të drejtohej nga Prokurori Publik vetëm sipas detyrës zyrtare. Personat e dëmtuar mund të marrin përsipër ndjekjen penale vetëm nëse Prokurori e braktis çështjen, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast konkret.

Më 23 Gusht të vitit 2005, me kërkesë të Prokurorisë, Instituti për mjekësi ligjore në Fakultetin e Medicinës në Beograd ka raportuar për rastin e z.Novakoviç. më 13 Dhjetor të vitit 2005 është bërë ekspertizë ligjore plotësuese.

Më 3 Prill të vitit 2006, Prokuroria ka bërë kërkesë për hetim penal për 9 mjekët e dyshuar për shkelje të rënda në shëndetin e z. Novakoviç. Në momentin e dorëzimit të kërkesës (më 10 Nëntor të vitit 2006) çështja në prokurori ka qenë ende në procedim.

Parashtuesit kanë pretenduar se shteti anëtar sipas nenit 6 të Paktit ka shkelur të drejtën e z. Novakoviç sepse nuk e ka mbrojtur të drejtën e jetës së tij. Ata i janë referuar

²¹ Vendimi është i disponueshëm në gjuhën angleze në: <http://hrlibrary.umn.edu/undocs/2073-2011.html>

edhe rastit të Lantsova v. Federata Ruse, ku është konstatuar se rreziku për jetë ka qenë i ditur. Parashtruesit konsiderojnë se standardi i njëjtë duhet të vlejë edhe për personat të cilët u janë besuar personelit mjekësor në spitalet shtetërore. Ata konsiderojnë se mjekët është dashur të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e z. Novakoviç, sipas raporteve të dorëzuara ishte e qartë se është bërë lëshim serioz nga pakujdesia e mjekëve. Autorët konsiderojnë se pakujdesia është bërë nga zyrtarë shtetëror, përkatësisht nga personeli spitalit të cilët nxisin përgjegjësinë dhe mossuksesin e shtetit për mbrojtjen e jetës në raste të caktuara.

Parashtresit ankohen për mungesë të hetimit të shpejtë dhe efikas për vdekjen e viktimës, siç është e paraparë në nenin 6 të Paktit. Ata pohojnë se kanë qenë të nevojshme 3 vite e 3 muaj para se të hapej procedura penale ndaj njërit prej mjekëve përgjegjës si dhe e njëjta konsiderohet si jo efikase. Parashtruesit konsiderojnë ky vonim ka qenë i tepërt dhe i referohen praksës gjyqësore së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (GjEDNj) i cili i konsideron si të paarsyeshme vonesat. Ata pohojnë se hetimi nga ana e Prokurorisë publike ka qenë i pamjaftueshëm dhe i referohen praktikës gjyqësore në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut.

RRJEDHA E PROCEDURËS:

Përgjigjja e shtetit

Shteti ka kërkuar që ankesa të shpallet si e papranueshme për shkak të mos shfrytëzimit të të gjitha mjeteve ligjore vendase, me arsyetimin se Kushtetuta e Republikës së Serbisë parasheh mundësinë e ankesës kushtetuese, të cilën prashtruesit e ankesës nuk e kishin shfrytëzuar. Sipas Kushtetutës së vendit, ky mjet ligjor mund të shfrytëzohet kundër organeve shtetërore të cilat kanë mohuar apo kanë kryer shkelje të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë, në rast se janë shfrytëzuar apo nuk janë paraparë mjetet të tjera ligjore. Gjithashtu, pranë Gjykatës Kushtetuese të R. Serbisë mund të parashtrohet ankesë edhe kur nuk janë të shterura të gjitha mjetet ligjore, në rast se është cenuar e drejta e paditësit për gjykim në një afat të arsyeshëm.

Shteti ka kërkuar që ankesa të shpallet e papranueshme për shkak të mos shfrytëzimit të të gjitha mjeteve ligjore vendase, siç edhe parashihet në dispozitën 96 (f) të Rregullores së Punës së Komitetit për të Drejtat e Njeriut. Si konkluzion shtesë, sipas shtetit palë, pretendimet se është cenuar neni 6 dhe neni 2 në lidhje me nenin 6 të Paktit, janë të pabazuara, me arsyetimin se akuza e ngritur ka qenë akoma në procedurë aktive pranë gjykatës vendase.

Përgjigjja e parashtruesve të ankesës mbi përgjigjen e shtetit

Parashtruesit pretendojnë se mjeti i referuar ligjorë – ankesa kushtetuese, nuk është efikas për arsye se Kushtetuta e R. Serbisë është shpallur më 8 nëntor 2006, përkatësisht 1 javë para se ankesa të parashtrohej pranë Komitetit, dhe se në momentin e parashtrimit të ankesës nuk kanë ekzistuar rregulla procedurale për parashtrimin e ankesës kushtetuese. Parashtruesit, gjithashtu, kanë theksuar se nga qershori i vitit 2009, një numër i madh i këtyre mjeteve ligjore janë shqyrtuar në procedura të cilat kanë zgjatur mbi 1 vjet e gjysmë, dhe se të njëjtat konsiderohen të pasigurta, si për nga vendimet ashtu edhe për nga mënyra e të vendosurit. Sa u përket kundra argumenteve të tjera të paraqitura nga shteti në lidhje me mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm kohor, autorët theksojnë se nga ana e tyre nuk është pretenduar se është shkelur e drejta e gjykimit të drejtë, por e drejta e jetës, sipas nenit 6 të Paktit, në bazë të mos suksesit për të mbrojtur jetën e tij, si dhe mungesës së një hetimi të shpejtë dhe efikas për humbjen e jetës në rastin z. Novakoviç.

VENDIMI I KOMITETIT MBI PRANUESHMËRINË E ANKESËS:

Komiteti ka konstatuar se çështja nuk është shqyrtuar në asnjë procedurë tjetër hetimi apo zgjidhje ndërkombëtare (siç edhe kërkohet sipas nenit 5, paragrafi 2, pika (a) të Protokollit Fakultativ).

Në lidhje me argumentet për mos shfrytëzimin e të gjitha mjeteve ligjore vendase, Komiteti rikujton praktikën e tij duke theksuar se për qëllimet e nenit 5, paragrafit 2, pika (b) të Protokollit Fakultativ, mjetet ligjore vendase duhet të jenë efikase dhe të disponueshëm. Komiteti, gjithashtu, ka mbështetur argumentet e parashtruesve se i përket ankesës kushtetuese, gjegjësisht se e njëjta sapo ishte krijuar si mundësi dhe nuk ka mundur të shfrytëzohet, me çrrastë është llogaritur si jo efikase dhe jo e disponueshme. Dhe për fund, në lidhje me procedurën e filluar penale për çështjen e ngritur, Komiteti konsideron se në rrethanat e këtij rasti, mjetet ligjore vendase janë prolonguar paarsyeshëm dhe se nenin 5, paragrafi 2, pika (b) nuk paraqet pengesë për shqyrtimin e ankesës.

VENDIMI I KOMITETIT MBI BAZUESHMËRINË E ANKESËS:

Sa i përket shkeljes së bërë të nenit 6 dhe nenit 2 të Paktit, në lidhje me vdekjen e z. Novakoviç si pasojë e trajtimit joadekuat mjekësor, Komiteti i është referuar komentarit të përgjithshëm nr. 6, sipas të cilit "... mbrojtja e të drejtës së jetës kërkon që shtetet palë të miratojnë masa pozitive për këtë qëllim". **Në rastin konkret, Komiteti konsideron**

se nuk ka prova të mjaftueshme të dorëzuara për t'ia vlrretuar shtetit përgjegjësinë e drejtpërdrejt për mos përmbushjen e detyrimeve sipas nenit 6 të Paktit.

Sido që të jetë, shteti nuk ka dhënë sqarime mbi funksionimin e Inspektoratit të Ministrisë së Shëndetësisë apo për efikasitetin e ndjekjes penale të rasteve të gabimeve mjekësore dhe kundërvajtjeve të tjera kundër shëndetit. Rrethanat e shumta të cilat kanë sjell vonesa në ngritjen e procedurës penale, fillimin i gjyqimit, apo raportit të parë mjekësor në lidhje me shkakun e vdekjes, në bazë të cilit më pas do bëhej ekspertiza mjeko-ligjore etj., tregojnë për faktin se ekzistojnë indikacione të forta sa i takon zbatimit të procedurave standarde mjekësore, si dhe ngrejnë dyshimin për neglizhencë të mundshme mjekësore dhe/apo kundërvajtje kundër shëndetit. Shteti nuk ka dhënë fare sqarime për këto pretendime, duke përfshirë këtu edhe shkaqet e prolongimit të fillimit dhe mbarimit të hetimit dhe procedurës penal për vdekjen e z. Novakoviç.

Komiteti konsideron se këto fakte nënkuptojnë mos përmbushje të obligimeve nga ana e shtetit palë sipas Paktit, për ta hetuar në mënyrë adekuate vdekjen e viktimës dhe për të ndërmarrë masa përkatëse ndaj personave përgjegjës dhe, duke u bazuar në këtë, të vërteton shkeljen e nenit 2, paragrafit 3 në lidhje me nenin 6 të Paktit.

Duke marrë parasysh shkeljet e konstatuara, Komiteti ka obliguar shtetin të ndërmerr hapa përkatës, edhe atë: (a) të sigurojë përfundim të shpejtë të procedurës penale, dhe (b) t'u sigurojë autorëve kompensimin e duhur. Shteti palë, gjithashtu, është i obliguar të parandalojë shkelje të ngjashme në të ardhmen. Njëkohësisht, Komiteti ka obliguar shtetin që brenda 180 ditëve ti përmbush detyrimet e lartpërmendura dhe për të njëjtat ta informojë Komitetin, si dhe qëndrimet e Komitetit t'i publikojë në ueb – faqen e saj.

LITERATURA E PËRDORUR

1. Ueb-faqet e Kombeve të Bashkuara dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut

1.1. Kombet e Bashkuara

- <https://www.un.org/en/global-issues/human-rights>

1.2. Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut

- <https://indicators.ohchr.org/>
- <https://www.ohchr.org/en/node/33623/membership>
- <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/ccpr/reporting-procedure>
- <https://juris.ohchr.org/en/search/results?Bodies=8&sortOrder=Date>
- <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/ccpr/general-comments>
- <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/individual-communications#overviewprocedure>
- <https://www2.ohchr.org/english/bodies/docs/annex1.pdf>
- <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/complaints-about-human-rights-violations>
- <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/Guidance-note-for-complaints-form-E.docx>

1.3. Claiming Human Rights, http://www.claiminghumanrights.org/ccpr_individual_communications.html

1.4. Rregullorja e punës së Komitetit për të Drejtat e Njeriut, CCPR/C/3/Rev.12, 4 janar 2021, i disponueshëm në gjuhën angleze në:

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CCPR%2fC%2f3%2fRev.12&Lang=en

2. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në gjuhën maqedonase mund ta gjeni në: https://unicode.org/udhr/d/udhr_mkd.html

3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

- I disponueshëm në gjuhën maqedonase në: <https://bezomrazno.mk/wp-content/uploads/2013/10/Megjunaroden-pakt-za-gragjanski-i-politicki-prava.pdf>
- I disponueshëm në gjuhën angleze mund të gjeni në: <https://www.ohchr.org/sites/default/files/ccpr.pdf>

3.1. Protokolli Fakultativ për parashtrimin e ankesave individuale, i disponueshëm në gjuhën angleze në: <https://www.ohchr.org/sites/default/files/ccpr-one.pdf>

3.2. Protokolli i Dytë Fakultativ për heqjen e dënimit me vdekje, i disponueshëm në gjuhën angleze në: <https://www.ohchr.org/sites/default/files/ccpr-death.pdf>

4. Vendimi për aderimin e R.M.S në dokumentet juridike ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të miratuara nga OKB-ja, i publikuar më 23.09.1993 në "Gazeta Zyrtare" nr. 57/1993.

5. J. Ananiev, B. Arifi, N. Gaber Damjanovska, M. Lazarova – Trajkovska, Zh. Poposka, S. Çubriq, Të drejtat e njeriut, OSBE, 2018, i disponueshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/7/0/385947.pdf>

6. FLAC, Promoting access to justice, A guide for taking individual complaints to UN Human Rights Treaty Bodies, I disponueshëm në: https://www.flac.ie/assets/files/pdf/guide_for_taking_individual_complaints_to_un_treaty_bodies.pdf

7. Nga praktika e Komitetit për të Drejtat e Njeriut:

- Naidenova et al. v. Bulgaria No. 2073/2011, <http://hrlibrary.umn.edu/un/docs/2073-2011.html>
- S. I. D. et al. v. Bulgaria No. 1926/2010, Jurisprudence (ohchr.org)
- Marija and Dragana Novaković v. Serbia No. 1556/2007, Jurisprudence (ohchr.org)

DORACAК

PËR PARASHTRIMIN E ANKESAVE INDIVIDUALE
PRANË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

UDHËZIME DHE HAPA TË THJESHTË



M3MP

ul. Donbas br. 14/1-6, 1000 Skopje
tel: 02/3220-870,
email: contact@myla.org.mk,

web: www.myla.org.mk